



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 12.05.2022, te restaurant “Anija” në Janjevë me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
4. Shahadije Bikilqi Dragaçina, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Idajet Garip, anëtar
7. Slavisa Trajkovic, anëtar
8. Zoran Cirkovic, anëtar
9. Ana Guciq, anëtare

Të tjerë prezent

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
5. Fisnik Dida, OSBE
6. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu,**

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Plani i punës së Komitetit për Komitete për vitin 2022
2. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Plani i punës së Komitetit për Komitete për vitin 2022

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, tha se draft planin e punës së komitetit për vitin 2022 sektori i kuvendit ua ka dërguar me kohë, pastaj pyeti anëtarët e komitetit a keni ndonjë propozim apo vërejtje .

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se një plan orientus i mirë te cilin e përkrahu, por kam një propozim qe ne muajin qershor te ftohet edhe drejtoresha e QPS-së.

Daut Azemi, tha se ne plan e keni të përfshirë informatën nga QPS-ja .

Skender Bikliqi, tha se sa i përket vizitave te komunitete na mundemi me i vizituar te gjitha komunitetet. Por prapë ju nëse keni ndonjë propozim më ndryshe e diskutojmë ne?

Daut Azemi, tha se duhet ju te bëni një plan se cilat vende do ti vizitoni, ku do te takoheni?

Fisnik Dida nga OSBE-ja, tha qe është mirë qe ti diskutoni te gjitha çështjet një nga një, dha idetë qe janë më të mira për komunitetin te merren parasysh.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne te kaluarën ne i vizitojshim si komiteti për komitete disa familje te komuniteteve ne Gadime,

Zoran Cirkovç, tha se pajtohna me kryesuesin se ne duhet te kemi një plan se cilat vende do ti vizitojmë a do te dalim ti vizitojmë ndonjë familje apo do kemi ndonjë plan tjetër.

Lulzim Qerimi, tha se unë e kam një propozim qe çdo seancë qe e kemi ne pikën të ndryshme te diskutojmë për takimin e ardhshëm për vizitat qe do ti kemi ne teren.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

III

Të ndryshme

Fisnik Dida, nga OSBE-ja, tha se kam një propozim qe çështjet qe janë me rendësi për komunitetet dhe te cilat diskutohen ne komitet te barten edhe ne kuvend nga anëtarët e komitetit te cilat janë përfaqësuese te kuvendit.

Daut Azemi, tha se anëtarët e kuvendit ngrisin ne kuvend edhe shqetësimet qe dalin nga ana e komiteteve dhe ne fund te vitit ne kuvend do te jetë një raport nga komitetet për punën e tyre.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14²⁰.

